



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE**  
**SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT**

Nr. 693/2 Prot.

Tiranë, më 24.03.2026

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 3329/1 PROT., DATË 16.02.2026 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. ALBENC AGO”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga z. Albenc Ago, me nr. 2439 prot., datë 28.07.2023 dhe nr. 2439/1 prot., datë 28.07.2023, në të cilat nuk ngrihen pretendime konkrete për veprime/mosveprime ndaj ndonjë magjistrati dhe me vendimin nr. 3329/1 prot., datë 16.02.2026, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. Albenc Ago”, bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesave. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e deklaruar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës në fletëlirim in e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al)

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETARI PËRGJITHSHËM**

